



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Komuna e Deçanit

Dt. 19 / 07 / 2021

Duke u bazuar në vendimin me nr. 19871 të datës 13.07.2021 për Shpalljen Gjendje Emergjente në tërë Territorin e Komunës së Deçanit, për epideminë që ka ndodhur si pasojë e infektimit nga uji i pijes.

Bazuar në rekomandimet e Shtabit për Menaxhimin e Emergjencave në takimin e mbajtur sot, më dt.19.07.2021: Kryetari i Komunës së Deçanit merr këtë:

V E N D I M

1. Ndërpritet Gjendja Emergjente në Tërë Territorin e Komunës së Deçanit, e shpallur me vendim të Kryetarit më dt.13.07.2021.
2. Të gjitha institucionet e nivelit lokal dhe drejtoritë komunale i kthehen normalitetit dhe orarit të rregullt të punës.
3. Komuna e Deçanit mbetet e përkushtuar për vazhdimin e implementimit të rekomandimeve të dalura sipas komunikatës së fundit të IKSHPK-së.
4. Komuna e Deçanit do të bëjë furnizimin me ujë të pijes sipas rekomandimeve të IKSHPK-së.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Arkivi i Komunës
2. Institucionet e nivelit lokal
3. Institucionet e Nivelit Qendror të Republikës së Kosovës
4. Kuvendi i Komunës së Deçanit



Kryetari i Komunës
z.Bashkim Ramosaj